



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 201 prot.

Kamëz, më 21/12 2022

V E N D I M  
Nr. 174.Datë 21/12 2022  
M B I

**“EMËRTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.12.2022, pasi mori në shqyrtim kërkesën për emërtim të rrugës nga “Islam Spahiu” në datë 16.12.2022 në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

**V E N D O S I :**

1. Emërtimin, “**Islam Spahiu**” rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

